



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr.177, datë 25.04.2023**

**PËR**

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}  
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË  
GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR POZICIONIN  
E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.  
504 DATË 21.11.2022, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E  
PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË  
KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.04.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të kandidatës znj. {...}”, përparitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

**VËREN**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Me Vendimin nr. 504, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë në fushën e të drejtës penale*

2. Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë për në Gjykatës e Apelit Korçë, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të

Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 21.11.2022, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 05.12.2022.

3. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), gjyqtare në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, aktualisht e transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për një periudhë një vjeçare.

4. Me Vendimin nr. 66, datë 09.02.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

*“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*2. Caktimin e relatorit si më poshtë: 27.Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro.*

5. Më datë 10.02.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Më datë 23.02.2023, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet,

pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 16.03.2023, pranë ILDKPKI-së.

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 09.03.2023, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

10. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

11. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrat të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

11.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr. 1732/3 prot., datë 09.03.2023, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

11.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushat e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarës, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë

dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, informacioni iu kërkua të dyjave këtyre gjykatave. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 1791/3 prot., datë 06.04.2023, siç do të përshkruhet më poshtë, ndërsa nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 155/1 prot., datë 13.03.2023, siç do të përshkruhet më poshtë

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT**

### **12. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.**

13. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*.

14. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022.

15. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008, ndërkohë që me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5476, datë 05.10.2007, “Për caktimin e përkohshëm të kandidatëve për magjistratë, për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë”, ajo është emëruar si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 05 tetor 2007 deri në 25 mars 2009, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile si dhe çështje penale. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6107, datë 25.03.2009, “Për emërim gjyqtari”, ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Pranë kësaj gjykate, kandidatja ka gjykuar çështje civile, administrative dhe çështje penale të gjitha kategorive Në vijim me Vendim nr. 109 datë 23.7.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë znj. {...} është deleguar përkohësisht për të kryer funksionin e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje.

16. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} ka filluar detyrën me

Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5476, datë 05.10.2007, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.6107, datë 25.03.2009, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje ku vijon të ushtrijë funksionin dhe aktualisht. Së fundi me Vendim nr. 109 datë 23.7.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë znj. {...} është deleguar përkohësisht për të kryer funksionin e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Me vendim nr. 293, datë 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet zgjedhja si Anëtare e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, me një mandat 4 vjeçar. Me vendim nr. 97, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për një periudhë një vjeçare. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 15 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

17. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë, duke plotësuar kështu kriterin “përvojës profesionale minimale”.

18. Sipas informacionit elektronik dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, (lista e çështjeve për periudhën 05.10.2007-31.12.2008), rezulton që kandidatja të ketë gjykuar gjithsej 53 çështje civile me natyrë të përgjithshme, 11 kërkesa civil, 2 kërkesa penale dhe 4 çështje penale.

19. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, rezulton që kandidatja referuar dhe urdhërin nr. 05 datë 10.01.2011; nr.04 datë 04.01.2013 dhe vendimit nr.168 prot., datë 25.06.2019 të kryetarit të gjykatës është vendosur që të gjykoj çështje civile /tregtare si dhe penale.

20. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

**21. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.**

22. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

23. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 30.11.2022, nëpërmjet të cilëve, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”*.

24. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

25. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*”.

## **26. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “*papajtueshmërisë ambientale*”.**

27. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficientia e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

28. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 30.11.2022, nëpërmjet të cilëve, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

29. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

30. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

### **III. KONKLUZIONE**

31. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

32. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijim e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar si dhe në pikën 9, të Vendimit nr. 504, datë 21.11.2022, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë në fushën e të drejtës penale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **VENDOSI:**

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale,

të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**